



AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA UPOREDIVANJE I VERIFIKACIJU IMOVINE
KOSOVO PROPERTY COMPARISON AND VERIFICATION AGENCY



Për verifikim të pronës private • Za verifikaciju privatne imovine • For private property verification

RAPORT VJETOR

I AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

Janar – Dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave

Fjalë hyrëse në emër të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë

1. Përmbledhje Ekzekutive

2. Korniza Ligjore

2.1 Baza ekzistuese ligjore që rregullon Agjencinë

2.2 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

3. Përshkrimi i Institucionit

3.1 Misioni

3.2 Vizioni

3.3 Kompetencat e AKKVP

4. Organizimi i Brendshëm, Personeli dhe Asetet

4.1 Bordi Mbikëqyrës

4.2 Sekretaria Ekzekutive

4.3 Komisionet

4.3.1 Komisioni për Verifikim dhe Vendorsje për Prona (KVVP)

4.3.2 Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP)

4.4 Burimet njerëzore, personeli dhe aftësimi profesional

4.5 Asetet

5. Aktivitetet e Agjencisë për Periudhën Raportuese dhe të Dhëna Tjera të Rëndësishme

5.1 Zbatimi i mandatit të AKKVP-së lidhur me krahasimin e dokumenteve kadastrale

5.1.1 Pjesëmarrja e AKKVP-së në Komitetin Ndërmintor për Administrimin e Tokës dhe Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Hapësinor (IKIH)

5.2 Përbushja e objektivave për mandatin trashëgues të Agjencisë

5.3 Njoftimi për kërkesat

5.4 Verifikimi i dokumenteve

5.5 Vendorsja e kërkesave nga KKPK

5.6 Shpërndarja e vendimeve të KKPK-së dhe Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme

5.7 Ankesat e pranura kundër vendimeve të KKPK-së

5.8 Zbatimi i vendimeve të KKPK-së

5.9 Zbatimi i vendimeve të KKPB-së

5.10 Administrimi i pronës

5.11 Skema e qiradhënies vullnetare

5.12 Aktivitetet e dëbimit

5.12.1 Lirimi i pronave në Regjionin e Mitrovicës/Komunat e Veriut

5.13 Rastet e ri uzurpimit serik

5.14 Mbyllja e Kërkesave

5.15 Ndërmjetësimi

5.16 Aktivitete Mbështetëse Administrative

5.16.1 Njësi i Administratës

5.16.2 Aktivitetet e Prokurimit

5.17 Veprimtaritë informative dhe shpërndarja e informatave për publikun

5.17.1 Transparenca dhe Informimi

5.17.2 Bashkëpunimi në mes Agjencive

5.17.3 Roli i AKKVP-së në Projektin e Rindërtimit të Kadastrës

6. Sfidat e Institucionit/Rekomandimet

6.1 Sfidat e vitit raportues

6.1.1 Procesi i kthimit të dokumenteve origjinale të skanuara kadastrale

6.1.2 Zbatimi i vendimeve të KKKP-së duke aplikuar mjetin juridik të shkatërrimit të strukturave të paligjshme

6.1.3 Personeli

7. Financimi dhe Buxheti

7.1 Financimi

7.2 Zbatimi i Buxhetit

8. Adresimi i Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

9. Ngjarjet Kryesore Gjatë Vitit 2024

10. Shtojcat

Shtojca A - Struktura organizative e AKKVP-së

Shtojca B - Struktura organizative e AKKVP-së e miratuar me rregulloren e re për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Shtojca C - Buxheti i AKKVP-së për vitin 2024

Shtojca D - Buxheti i rishikuar i AKKVP-së për 2024

Shtojca E - Pasqyrat e shpenzimeve të Buxhetit të AKKVP-së për 2024

LISTA E SHKURTESAVE

AKKVP	-	<i>Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (Agjencia)</i>
KVVP	-	<i>Komisioni për Verifikimin dhe Vëndosje për Pronë</i>
KKPK	-	<i>Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës</i>
AKP	-	<i>Agjencia Kosovare e Pronës</i>
DÇPB	-	<i>Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore</i>
KKPB	-	<i>Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore</i>
AKK	-	<i>Agjencia Kadastrale e Kosovës</i>
OJQ	-	<i>Organizatë Jo-Qeveritare</i>
PPBE	-	<i>Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian</i>
EULEX	-	<i>Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit</i>
OSBE	-	<i>Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian</i>
UNHCR	-	<i>Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë</i>

FJALË HYRËSE NË EMËR TË SEKRETARISË EKZEKUTIVE TË AGJENCISË

Ndërsa shënojmë një vit të punës së palodhshme dhe të përkushtuar, në rolin tim si Drejtore e Sekretarisë Ekzekutive, e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në qershor 2023, kam nderin të paraqes Raportin Vjetor të Punës për vitin 2024, i cili ofron një pasqyrë të punës sonë, angazhimeve dhe arritjeve lidhur me zbatimin e mandatit, por edhe të sfidave përgjatë këtij viti.

Fillimisht, dua të shpreh kënaqësinë time që mund të deklaroj se, pavarësisht sfidave të paraqitura edhe në këtë raport, Agjencia ka arritur rezultate të shkëlqyera në realizimin e mandatit të saj, si dhe në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tjera, dhe krejt kjo falë angazhimit të jashtëzakonshëm të të gjithë punonjësve të Agjencisë.

Pra, Agjencia ka vazhduar me sukses zbatimin e mandatit të trashëguar nga ish-AKP dhe DÇPB, ndërkohë që, pas përgatitjeve të shumta dhe të vazhdueshme dhe besimit të dhënë nga Kuvendi, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-010, Agjencia ka marrë një mandat shtesë për njohjen formale, sipas këtij ligji, të të drejtave pronësore që janë fituar para datës 24 mars 1999 si rezultat i një transaksioni joformal.

Në lidhje me këtë mandat shtesë, Agjencia ka bërë përgatitje të rëndësishme për zbatimin e tij të suksesshëm, duke siguruar adresimin efikas të kërkesave për njohjen formale të të drejtave pronësore. Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Agjencia ka nisur një fushatë informuese për njohjen ligjore të të drejtave pronësore joformale.


Për sa i përket mandatit të krahasimit dhe verifikimit të dokumenteve kadastrale, është e rëndësishme të theksohet se edhe gjatë këtij viti raportues, nuk ka filluar procesi i kthimit të dokumenteve kadastrale nga Serbia, siç parashihet në Marrëveshjen e Brukselit. Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2024, Agjencia nuk ka mundur të fillojë zbatimin e kësaj pjese të mandatit. Megjithatë, duke pasur parasysh përgatitjet e Agjencisë, ne mbetemi të përkushtuar dhe të gatshëm për të nisur këtë proces sapo të fillojë kthimi i dokumenteve kadastrale.

Pavarësisht kësaj, ne jemi të vendosur të vazhdojmë të punojmë me përkushtim në realizimin e mandatit dhe të përballemi me sfidat e reja me profesionalizëm. Përkushtimi dhe angazhimi i Agjencisë në realizimin sa më të suksesshëm të mandatit të saj më bëjnë të jem e bindur se në të ardhmen rezultatet do të jenë edhe më të mëdha.

Në mbyllje, dëshiroj të shpreh mirënjohje në emër të Agjencisë për mbështetjen e vazhdueshme të Kuvendit, Qeverisë, Bordit Mbikëqyrës dhe të gjithë partnerëve tanë.

Ju faleminderit!

Afërdita Beka – Arifaj



Drejtores e Sekretarisë Ekzekutive

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i AKKVP-së për periudhën janar-dhjetor 2024 prezanton arritjet dhe angazhimet e Agjencisë për zbatimin e mandatit, por edhe sfidat gjatë këtij viti.

Më 9 qershor 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës. Krahaskim mandati për të zgjidhur zbrastëtitë dhe mospërrputshmëritë mes dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit të vitit 1999, të marra nga autoritetet serbe, dhe dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, ky ligj kishte trashëguar gjithashtu mandatin e ish-AKP-së.

Pas miratimit nga Kuvendi më 23 dhjetor 2022 të Ligjit 08/L-052 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 05/L-010, Agjencia ka në mandat gjithashtu pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për njohje ligjore të të drejtave pronësore, të pakontestuar dhe legjitime, mbi pronat e paluajtshme, të bartura përmes transaksioneve joformale para 24 qershorit 1999, bartja formale e të cilave është ndaluar nga legjislacioni diskriminues, ose për të cilat dokumentet e kërkuara për regjistrim në sistemin kadastral të Kosovës nuk ekzistojnë. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka bërë përgatitje të shumta dhe të rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të këtij mandati, përfshirë fushatën informuese, zhvillimin e platformës online për parashtrimin e kërkesave, si dhe përgatitje të tjera të rëndësishme organizative dhe teknike.

Sa i përket mandatit të krahaskimit dhe verifikimit të dokumenteve kadastrale, gjendja mbetet e njëjtë siç është raportuar edhe më parë. Procesi i kthimit të dokumenteve kadastrale nga Serbia nuk ka filluar, ashtu siç parashihet në Marrëveshjen e Brukselit. Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2024, Agjencia nuk ka mundur të fillojë zbatimin e kësaj pjese të mandatit. Duke pasur parasysh përgatitjet për këtë mandat, të raportuara edhe më parë, Agjencia është e gatshme për zbatimin e tij, në pritje të nisjes së kthimit të dokumenteve kadastrale.

Lidhur me përgjegjësitë e trashëguara nga ish-AKP dhe DÇPB, Agjencia ka vazhduar të zbatojë me sukses këtë pjesë të përgjegjësisë. Ashtu siç është raportuar edhe në vitet paraprake, paraardhësja e AKKVP-së, AKP, ka përfunduar me sukses procesin e përpunimit dhe referimit për vendosje të të gjitha kërkesave të parashtruara në Agjenci. Pra, përgjegjësitë e trashëguara kryesisht kanë të bëjnë me zbatimin e këtyre vendimeve nëpërmjet mjeteve të parapara ligjore.

Sa i përket këtyre përgjegjësisë, gjatë periudhës raportuese Agjencia ka pranuar 15 kërkesa për vënien e pronës nën administrim dhe 275 kërkesa për mbyllje të rasteve, të parashtruara nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. Janë përpunuar për mbyllje 8 kërkesa të hedhura poshtë/refuzuar me vendimin e Komisionit, për të cilat brenda afatit ligjor Agjencia nuk ka pranuar ankesë, ndërsa 153 kërkesa të tjera janë dërguar për mbyllje për shkak të mosbashkëpunimit. Numri i përgjithshëm i vendimeve të zbatuara të KKPK-së, gjatë periudhës së raportimit, është 324. Agjencia gjithashtu ka pranuar 1 ankesë kundër vendimit të KKPK-së, e cila është dërguar në Gjykatën Supreme, ndërsa 525 kërkesa janë mbyllur nga Agjencia.

Sa i përket administrimit të pronave, gjatë periudhës raportuese, në total kanë qenë 11,386 prona nën administrim të Agjencisë, edhe pse në 29 raste bartësi i së drejtës pronësore/pronari ka paraqitur kërkesë për ndërprerjen e administrimit. Gjatë vitit 2024, me hyrjen në fuqi të akteve nënligjore, Agjencia ka filluar zbatimin e skemës së qirasë vullnetare për 3,597 prona të përshtatshme për qiradhënie, duke nisur me kontaktimin e Bartësve të të Drejtave Pronësore për të marrë pëlqimin e tyre lidhur me zbatimin e skemës së qirasë dhe ka lidhur marrëveshje qiraje për 54 prona.

Sa i përket riposedimit të pronave, ka pasur gjithsej 32 kërkesa fillestare për ri-posedim të pronës, ku nga këto janë realizuar 12 dëbime me mbështetjen e Policisë së Kosovës. Në fund të vitit 2024, ka pasur 41 kërkesa në pritje, prej të cilave 12 raste dëbimi janë në pritje për tu planifikuar me mbështetje nga Policia e Kosovës. Me qëllim të bashkëpunimit dhe mbështetjes së AKKVP-së për finalizimin e procedurave të dëbimit, është ripërtërirë Marrëveshja e Bashkëpunimit mes AKKVP-së dhe Policisë së Kosovës.

Lidhur me ndërmjetësimin, gjatë vitit 2024, Agjencia ka vazhduar aplikimin e këtij mjeti ligjor. Nga gjithsej 88 raste të identifikuara me strukturë të paligjshme të ndërtuar nga shfrytëzuesit e paligjshëm në pronat e paraqitësve të kërkesave, deri më tani, në 50 prej tyre është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit, në 23 raste palët nuk kanë arritur marrëveshje, dhe në 14 raste, me kërkesë të palëve, është rifilluar procesi i ndërmjetësimit. Gjatë vitit raportues janë zbatuar 4 lëndë si rezultat i marrëveshjeve përmes ndërmjetësimit.

Në vitin 2024, dhe në mënyrë të vazhdueshme, Agjencia është përballur me vështirësi financiare që lidhen me financimet nga donatorët, me theks të veçantë mbajtjen e personelit profesional aktual dhe rekrutimin e ekspertëve të domosdoshëm për zbatimin e mandatit me sukses.

Njësi i Prokurimit ka trajtuar me sukses 56 kërkesa të prokurimit të pranuar gjatë vitit 2024. Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në përputhje me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik (04/L-042). Vlen të theksohet se edhe gjatë vitit 2024, Agjencia ka vazhduar me përdorimin e kontratave të centralizuara, të zhvilluara nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

Në përpjekje për t'iu dhënë informacione institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, Agjencia është takuar rregullisht me institucionet dhe aktorët e tjerë të fushës së të drejtave pronësore, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit mbi punën e saj dhe rëndësinë e saj për ndërtimin e paqes, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit.

Vlen të theksohet se Agjencia ka përcaktuar objektiva për vitin 2025, të cilat synojnë, ndër të tjera, vazhdimin me sukses të zbatimit të mandatit të saj. Përveç vazhdimin të angazhimit për procesin e krahasimit dhe verifikimit të dokumenteve kadastrale, për të cilin, siç u theksua, tashmë janë bërë përgatitje të shumta, janë përcaktuar edhe objektiva të tjera lidhur me përgjegjësitë e trashëguara dhe me procesin e formalizimit të të drejtave pronësore të bartura përmes transaksioneve joformale, bazuar në Ligjin 05/L-010 të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 08/L-052.

Objektivat lidhur me përgjegjësitë e trashëguara të ish-AKP-së dhe DÇPB-së synojnë vazhdimin e zbatimit të suksesshëm të kësaj pjese të përgjegjësisë, duke përfshirë: zbatimin e vendimeve të KKPK-së dhe KKPb-së, si dhe ri-aranzhimin me palët për shpërndarjen e vendimeve të KKPK-së; përpunimin e dosjeve (duke përfshirë përkthimin e ankesave dhe dokumenteve të pranuara) për Panelin e Ankesave në Gjykatën Supreme, si dhe pranimin, përkthimin dhe shpërndarjen e urdhrave nga Paneli i Ankesave të Gjykatës Supreme tek palët. Objektiva të tjera përfshijnë administrimin dhe inspektimin e rregullt të 11,386 pronave, zbatimin e skemës vullnetare të qirasë për 3,597 prona, vazhdimin e procesit të ndërmjetësimit në 14 rastet që janë duke u zhvilluar, përfshirë lëndët e reja të pritshme, verifikimin e dokumenteve lidhur me zbatimin e kërkesave nga mandati i AKP-së dhe DÇPB-së, si dhe menaxhimin e vazhdueshëm të të dhënave dhe 71,000 dosjeve të AKKVP-së, etj.

Siç u theksua më lart, janë përcaktuar objektiva edhe për procesin e formalizimit të të drejtave pronësore, ashtu siç parashihet në ligjin e lartpërmendur. Prandaj, gjatë vitit 2024, Agjencia ka zhvilluar kampanjën informuese lidhur me mundësitë për njohjen e të drejtave pronësore përmes Agjencisë dhe ka organizuar trajnime për stafin mbi adresimin e informalitetit. Objektiva të tjera përfshijnë hartimin e procedurave standarde operative të brendshme për secilën njësi organizative, duke themeluar praktikatat më të mira në bazë të kompetencave, rregullimin e infrastrukturës së nevojshme të teknologjisë informative, pranimin e kërkesave, si dhe përpunimin e lëndëve për t'u paraqitur para KKPK-së për vendimmarrje, etj.

Në fund, Agjencia dëshiron të shprehë mirënjohjen e saj për të gjitha institucionet, organizatat dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë kontribuar dhe ndihmuar Agjencinë përgjatë viteve. Njëkohësisht, Agjencia mbetet e përkushtuar të zbatojë mandatin e saj kushtetues dhe ligjor në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore për të gjithë qytetarët pa dallim.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1 BAZA EKZISTUESE LIGJORE QË RREGULLON AGJENCINË

AKKVP është themeluar me Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-052. Për zbatimin e këtij ligji, janë në fuqi aktet nënligrjore si më poshtë:

- Rregullore (QRK) Nr. 18/2023 për Procedurat e Trajtimin të Informalitetit nga Agjencia Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës
- Rregullore (QRK) Nr.19/2023 për Rregullat dhe Procedurat Rreth Administrimit të Pronave dhe Zbatimit të Skemës Vullnetare të Qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës
- Rregullore (QRK) Nr. 08/2017 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Procedurat e Komisioneve të Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.20/2023)
- Rregullore (QRK) Nr. 21/2023 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Organizimin e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës
- Rregullore (QRK) Nr. 09/2023 për Përcaktimin e Procedurave për Shkatërrimin e Strukturave të Paligjshme
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 10/2018 për Procedurat e Skemës së Kompensimit për Zbatimin e Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.06/2017 lidhur me Lirimin e Bartësve të së Drejtës së Pronësisë apo Shfrytëzimit nga Borxhet e Shërbimeve Publike Komunale për Pronat e Uzurpuara dhe Nën Administrimin e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës
- Rregullore (QRK) nr. 09/2017 për Punën e Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. MISIONI

Krahasimi dhe verifikimi i drejtë dhe efikas i dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit të vitit 1999, të cilat janë marrë nga autoritetet serbe dhe që kanë të bëjnë me pronën private, pronën private komerciale dhe pronën e bashkësive fetare në Kosovë, si dhe krahasimi i këtyre dokumenteve me ato të aktualizuara në sistemin kadastral të Republikës së Kosovës; zbatimi i vendimeve të KKKP-së, KKP-së dhe Gjykatës Supreme, si dhe shqyrtimi dhe vendosja për kërkesat e parashtruara për njohje ligjore të të drejtave pronësore të pakontestuar dhe legjitime mbi pronat e paluajtshme, të bartura përmes transaksioneve joformale para 24 marsit 1999, bartja formale e të cilave është ndaluar nga legjislacioni diskriminues, ose për të cilat dokumentet e kërkuara për regjistrim në sistemin kadastral të Kosovës nuk ekzistojnë.

3.2. VIZIONI

Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtës pronësore private dhe, për rrjedhojë, përmirësimi i jetës së qytetarëve si e drejtë themelore e njeriut, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Neni 46), si akti më i lartë juridik i vendit, mbështetur gjithashtu në të gjitha parimet universale të konventave ndërkombëtare.

3.3. KOMPETENCAT E AKKVP-SË

AKKVP është një institucion i pavarur i themeluar sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-052. Në bazë të këtij ligji, AKKVP ka këto kompetenca:

- Pranon, krahason, verifikon dhe përmes KVVP-së, zgjidhë zbrazëtitë dhe mospërputhshmëritë në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit të vitit 1999, të cilat janë marrë në Kosovë nga autoritetet serbe dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën e bashkësive fetare.
- Përmes KKP-së, do të vazhdojë të rishqyrtojë kategoritë vijuese të kërkesave të parashtruara, gjatë mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës, e që janë të lidhura me luftën në Kosovë, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to, ose janë pasojë e saj, në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:
 - a. Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale;

b. Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale;

- Pranon, shqyrton dhe përmes KKP- së vendos për kërkesat e parashtruara për njohje ligjore të të drejtave pronësore, të pakontestuar dhe legjitime, mbi pronat e paluajtshme, të bartura përmes transaksioneve joformale para 24 marsit 1999, bartja formale e të cilave është ndaluar nga legjislacioni diskriminues apo për të cilat dokumentet e kërkuara për regjistrim në sistemin kadastral të Kosovës nuk ekzistojnë;
- Të zbatojë vendimet e KKP, KKP dhe KVVP;
- Të administrojë pronat me kërkesën e paraqitësit të suksesshëm të kërkesës;
- Të zbatojë skemën vullnetare të qirasë për pronat nën administrim të AKKVP-së.

4. ORGANIZIMI I BRENDSHËM, PERSONELI DHE ASETET

Sipas Ligjit Nr.05/L-010 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-052, AKKVP përbëhet nga katër organe kryesore, përkatësisht nga:

- Bordi Mbikëqyrës;
- Sekretaria Ekzekutive;
- Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona;
- Komisioni për Kërkesa Pronësore.

4.1. BORDI MBIKËQYRËS

Bordi Mbikëqyrës përbëhet prej pesë anëtarëve, tre nga anëtarët e tij janë ndërkombëtarë dhe dy anëtarë vendorë, të cilët emërohen sipas legjislacionit në fuqi. Bordit Mbikëqyrës i është dhënë mandati të mbikëqyrë punën e Agjencia dhe t'i ofrojë udhëzime për politikën dhe orientimin përgjithshëm të Agjencisë. Megjithatë, është i përjashtuar nga marrja pjesë në procesin me të cilin KVVP dhe KKP merr vendimet e veta. Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive e përfaqëson Sekretarinë Ekzekutive para Bordit Mbikëqyrës dhe Sekretaria Ekzekutive gjithashtu i ofron shërbime administrative Bordit. Kjo përfshin: organizimin e mbledhjeve të Bordit, shpërndarjen e dokumenteve dhe informacioneve relevante dhe monitorimin e veprimeve të ndërmarra në lidhje me instruksionet, këshillat dhe udhëzimet e Bordit.

Anëtarët e Bordit të Agjencisë janë:

- **Zt. Hamit Basholli**, Kryesues i Bordit Mbikëqyrës;
- **Znj. Danijela Barišić**, Ambasadore e Kroacisë, anëtare e Bordit Mbikëqyrës;
- **Znj. Minca Benedejcic**, Ambasadore e Sllovenisë, anëtare e Bordit Mbikëqyrës;
- **Znj. Selvete Gagica**, Anëtare e Bordit Mbikëqyrës.
- **Zt. Jarmo Feliks Helppikangas**, Udhëheqës i Seksionit të Sundimit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovës, anëtar i Bordit Mbikëqyrës;

Bordi Mbikëqyrës është takuar katër (4) herë gjatë periudhës së raportimit dhe ka miratuar Rregulloren për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, Organogramin, Raportin Vjetor për vitin 2023 dhe Planin vjetor të Performances për vitin 2025.

4.2. SEKRETARIA EKZEKUTIVE

Në kuadër të zbatimit të mandatit të AKKVP-së, Sekretaria ka këto përgjegjësi:

- Pranimin, regjistrimin dhe krahasimin e dokumenteve kadastrale origjinale të skanuara të para Qershorit të vitit 1999, të cilat janë marrë në Kosovë nga autoritetet serbe, e të pranuar përmes/nga Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian, me dokumentet kadastrale aktuale në Kosovë, me qëllim të identifikimit të zbrazëtive apo të mos përputhjeve në mes të këtyre dy grupeve të dokumenteve kadastrale;
- Krijimin e rasteve pas krahasimit të dokumenteve të pranuar dhe dokumenteve aktuale në Kosovë dhe pas konstatimit të zbrazëtive apo mospërputhjeve, dërgimi i këtyre rasteve për vendosje në Komisionin për Verifikim dhe Vendosje për Prona (KVVP);
- Pranimi, regjistrimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara për njohje ligjore të të drejtave pronësore, të pakontestuar dhe legjitime, mbi pronat e paluajtshme, të bartura përmes transaksioneve joformale para 24 marsit 1999; bartja formale e të cilave është ndaluar nga legjislacioni diskriminues apo për të cilat dokumentet e kërkuara për regjistrim në sistemin kadastral të Kosovës nuk ekzistojnë;
- Vazhdimin e zbatimit të kompetencave të bartura nga AKP;
- Mbështetjen e KVVP-së dhe KKP-së për vendosje, si dhe kompetenca dhe përgjegjësi tjera duke përfshirë:
 - njoftimin e palëve;
 - verifikimin e dokumenteve;
 - përgatitjen e rasteve për shqyrtim për KVVP dhe KKP;
 - nxjerrjen e vendimeve;
 - zbatimin e vendimeve përmes mjeteve juridike të parapara me ligj;
 - pranimin dhe dërgimin e ankesave në Gjykatën Supreme;
 - zbatimin e vendimeve të pazbatuara të KKP dhe KKPb
 - zbatimin e urdhrave për dëbim;
 - administrimin e pronave dhe zbatimin e skemës së qirasë vullnetare;
 - dërgimin e dokumenteve dhe vendimeve të plotfuqishme në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për regjistrim, etj.

Drejtori/ja udhëheq Sekretarinë Ekzekutive të AKKVP-së.

Pas shpalljes së konkursit për zgjedhjen e Drejtorit/es dhe Zëvendësdrejtorit/es të Sekretarisë Ekzekutive të AKKVP-së dhe kriterëve të përcaktuar me Ligj dhe me rregullore, Kryeministri cakton një Komision përzgjedhës. Pas vlerësimit të kandidatëve, Komisioni përzgjedhës i propozon Kryeministrit kandidatët e mundshëm për pozitën e Drejtorit/es dhe Zëvendësdrejtorit/es. Kryeministri pastaj i propozon Kuvendit një kandidat për Drejtor/e dhe një kandidat për Zëvendësdrejtor/e nga lista e propozuar nga Komisioni përzgjedhës. Drejtori/ja dhe Zëvendësdrejtori/ja emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri.

Njësitet kryesore¹ që janë përgjegjëse për plotësimin e detyrave kryesore në kuadër të kompetencave ligjore të Agjencisë janë:

- Zyrat Regionale
- Njësi i Informimit
- Njësi i Verifikimit
- Njësi i Përpunimit të Kërkesave
- Ekipi Mbështetës i KKPK-së
- Zyra e Regjistrimit
- Njësia për Administrim të Pronave
- Njësia e Zbatimit
- Njësia për Mbylljen e Kërkesave

Përveç njësive që lidhen me punën e drejtpërdrejtë për zbatimin e mandatit të Agjencisë, rol të rëndësishëm në Agjenci luajnë edhe njësitet² në vijim:

- Njësi i Administratës
- Njësi i Prokurimit
- Njësi i Buxhetit dhe Financave
- Njësi i Auditimit të Brendshëm
- Njësi i Përkthimeve
- Njësi i Burimeve Njerëzore
- Njësi i TI-së

Vlen të theksohet se gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka miratuar Rregulloren për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, e cila paraprakisht ishte miratuar nga Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë dhe kishte marrë mendim këshillimor pozitiv nga institucionet kompetente, siç parashihet me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka funksionuar sipas strukturës organizative paraprake, deri në finalizimin e sistematizimit të vendeve të punës.

4.3. KOMISIONET

Në përbërje të Agjencisë janë dy Komisione për vendosje të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e mandatit të AKKVP-së. Është e rëndësishme të theksohet se Sekretaria ofron mbështetje profesionale, ligjore, administrative dhe teknike për këto Komisione në realizimin e funksioneve të tyre ligjore, përmes Zyrës Mbështetëse të Komisioneve.

4.3.1. KOMISIONI PËR VERIFIKIM DHE VENDOSJE PËR PRONA

Në kuadër të mandatit të Agjencisë, Komisioni për Verifikim dhe Vendosje të Pronës (KVVP) është përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e dallimeve dhe mospërputhjeve mes dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit 1999, të cilat janë marrë nga autoritetet serbe dhe

¹ Gjatë vitit 2024, Agjencia ka funksionuar sipas strukturës së mëparshme organizative para miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

² Po aty

dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën e bashkësive fetare.

KVVP përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Dy (2) prej tyre emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Tre (3) anëtarë, përfshirë një (1) përfaqësues të komunitetit jo shumicë, emërohen nga PPBE, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

4.3.2. KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE

Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP) është një organ i pavarur, i mandatuar të vazhdojë shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave të mbetura të paraqitura në Agjencinë Kosovare për Pronë, lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. Gjithashtu, KKP ka përgjegjësinë të vendosë për kërkesat e paraqitura për njohjen ligjore të të drejtave pronësore joformale, të pakontestuara dhe legjitime, për pronën e paluajtshme, të cilat janë bartur ndërmjet palëve përmes transaksioneve joformale para datës 24 mars 1999, kur bartja formale është ndaluar nga legjislacioni diskriminues ose për pronat për të cilat dokumentet e kërkuara për regjistrim në sistemin kadastral të Kosovës nuk ekzistojnë.

KKP përbëhet nga tre (3) anëtarë. Një (1) anëtar emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ndërsa dy (2) anëtarë ndërkombëtarë emërohen nga PPBE, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.4. BURIMET NJERËZORE, PERSONELI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

Gjatë vitit 2024, Agjencia ka arritur me sukses, për herë të parë që nga viti 2010, të hartojë dhe miratojë Rregulloren 01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimit të vendeve të punës në AKKVP, dhe të përfundojë plotësisht procesin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e nëpunësve, në përputhje me legjislacionin për organizimin e administratës shtetërore dhe klasifikimin e vendeve të punës.

Në përputhje me legjislacionin për zyrtarët publikë dhe duke u bazuar në ndryshimet e reja me Rregulloren Nr. 01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Agjencia ka finalizuar përshkrimet e punës për secilën pozitë, të cilat janë miratuar nga zyrtari kryesor administrativ.

Komisioni i Ristrukturimit në Agjenci ka përfunduar procesin duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, përfshirë Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren Nr. 01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Rregulloren (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe Udhëzuesin Nr. 01/2024 për Procesin e Transferimit të Zyrtarëve. Si rezultat, është raporti me rekomandime për secilin nëpunës të Agjencisë.

Njësia për Burime Njerëzore me sukses ka zbatuar rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit, duke nxjerrë vendimet për transferimin dhe sistematizimin e secilit nëpunës të Agjencisë. Gjithashtu, janë përgatitur aktetëmërimet për secilin nëpunës, duke ofruar mbështetje ligjore dhe administrative për finalizimin me sukses të këtij procesi të rëndësishëm për funksionimin efektiv të Agjencisë dhe realizimin e kompetencave të saj ligjore.

Njësia e Burimeve Njerëzore ka zbatuar procedurat ligjore për menaxhimin dhe zhvillimin profesional të burimeve njerëzore në Agjenci gjatë vitit të kaluar.

Pas ndryshimeve në staf, Agjencia në fund të vitit raportues (dhjetor 2024), kishte njëqind e gjashtëdhjetë e tetë (168) nëpunës civilë. Nga këta njëqind e pesëdhjetë e gjashtë (156) ishin shqiptarë, nëntë (9) serbë dhe tre (3) turq.

Të gjithë nëpunësit kanë mundësinë të marrin pjesë në trajnime të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), AKKVP dhe institucione të tjera. Nevojat për trajnime avancuese dhe profesionale të stafit të Agjencisë mbeten të vazhdueshme.

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia është përballuar me sfida tëndryshme, megjithatë shumicën prej tyre i ka tejkaluar falë angazhimit dhe përkushtimit të vazhdueshëm të stafit profesional.

4.5. ASETET

Asetet e Agjencisë deri më 31 dhjetor 2024 janë detajuar si në vijim:

- Asetet me vlerë kapitale kanë vlerën në libër 697,599€
- Asetet me vlerë jo-kapitale kanë vlerën në libër 36,776€

Për të realizuar misionin e saj, Agjencia operon me një zyrë qendore dhe pesë zyra regjionale, për të cilat shpenzohet një pjesë e konsiderueshme e buxhetit. Pavarësisht përpjekjeve të Agjencise për të siguruar hapësira pune më ekonomike nga qeveria, deri më tani këto përpjekje kanë rezultuar pa sukses.

Në vitin 2024, Agjencia është pajisur me një automjet përmes prokurimit nga AQP, duke përdorur fondet e kategorisë së investimeve kapitale. Megjithatë, gjendja e automjeteve mbetet problematike për shkak të vjetërsisë dhe defekteve të shpeshta.

Në përputhje me Vendimin Qeveritar 02/194, datë 20 mars 2024, AQP është autorizuar për zhvillimin e procedurave të centralizuara të prokurimit në nivel qendror. Meqenëse procedurat e prokurimit, të zhvilluara nga AQP, janë finalizuar me vonesë (Njoftimi i AQP për kontratat e nënshkruara është bërë më 7 nëntor 2024), kjo ka ndikuar që plani i furnizimeve me vetura dhe pjesa buxhetore e AKKVP të mos mund të shpenzohen në pajtim me rregullat financiare, përkatësisht me afatin e përcaktuar nga Thesari për shpenzimet deri më 24 dhjetor 2024.

Në kuadër të mandatit të saj, Agjencia është e obliguar të kryejë inspektime të rregullta të pronave nën administrim, së paku dy herë në vit, në terrene të ndryshme, dhe për realizimin efektiv të tyre nevojiten automjete shtesë të përshtatshme.

5. AKTIVITETET E AGJENCISË PËR PERIUDHËN RAPORTUESE DHE TË DHËNA TJERA TË RËNDËSISHME

5.1. ZBATIMI I MANDATIT TË AKKVP-SË LIDHUR ME KRAHASIMIN E DOKUMENTEVE KADASTRALE

Edhe gjatë këtij viti raportues, procesi i kthimit të dokumenteve kadastrale nga Serbia nuk ka filluar. Mos fillimi i këtij procesi ka pamundësuar Agjencinë të ndërmarrë hapat për fillimin e zbatimit të mandatit të saj në lidhje me krahasimin, verifikimin dhe zgjidhjen e mospërputhjeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën e bashkësive fetare.

Agjencia ka përfunduar punët përgatitore më të rëndësishme për këtë pjesë të mandatit, siç janë hartimi i Metodologjisë së Punës, zhvillimi i softwarit të avancuar dhe trajnimet e specializuara për këtë aspekt. Prandaj, Agjencia është e gatshme të fillojë zbatimin e tij në pritje të nisjes së kthimit të dokumenteve kadastrale.

Gjatë këtij viti raportues, Agjencia ka zhvilluar takime pune dhe informuese me institucione të ndryshme, përfshirë Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit për zbatim sa më të suksesshëm të kësaj pjese të mandatit.

5.1.1 PJESËMARRJA E AKKVP-SË NË KOMITETIN NDËRMINISTROR PËR ADMINISTRIMIN E TOKËS DHE INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONIT HAPËSINOR (IKIH)

AKKVP ka marrë pjesë aktive në katër takime të Komitetit Ndërmnistror për Administrimin e Tokës dhe IKIH gjatë periudhës raportuese, duke kontribuar në diskutimet e politikave dhe harmonizimin e të dhënave kadastrale.

Komiteti Ndërmnistror për Administrimin e Tokës dhe IKIH u rithemeluan në vitin 2022 për koordinimin e politikave të administrimit të tokës. AKKVP është pjesëmarrëse aktive, duke siguruar:

- Verifikimin dhe saktësinë e të dhënave kadastrale
- Kontributet e politikave për reformat e administrimit të tokës
- Mbështetjen ligjore në harmonizimin e regjistrave të pronave

Gjithashtu, Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë i ka dërguar një shkresë zyrtare Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së për Bisedime Kosovë-Serbi, z. Lajçak, duke kërkuar që, në kuadër të bisedimeve, pala serbe të fillojë zbatimin e marrëveshjes për regjistrat kadastralë. Agjencia ka pranuar një përgjigje nga z. Lajçak, në të cilën kërkohet një sqarim i detajuar mbi mënyrën e zbatimit të kësaj marrëveshjeje nga Agjencia, dhe në takimin e mbajtur me PPBE në Kosovë, z. Aivo Orav, Agjencia prezantoi hapat e ndërmarrë për zbatimin e mandatit të saj në lidhje me regjistrat kadastralë.

5.2. PËRMBUSHJA E OBJEKTIVAVE PËR MANDATIN TRASHËGUES TË AGJENCISË

Synim i Agjencisë për vitin 2024 ka qenë vazhdimi i zbatimit të suksesshëm të mandatit të trashëguar nga AKP-ja. Bazuar në planifikimin dhe synimet operative për vitin 2024, Agjencia ka vazhduar me sukses realizimin e këtyre objektivave:

- Shpërndarja e vendimeve që ende nuk u janë dorëzuar palëve;
- Përpunimi i vendimeve individuale që janë në pritje të zbatimit;
- Shqyrtimi dhe, kur është e nevojshme, korigjimi i vendimeve individuale. Vendimet e korigjuara u janë dorëzuar palëve dhe për këtë është njoftuar edhe Agjencia Kadastrale e Kosovës;
- Paraqitësit e kërkesave dhe palët përgjegjëse janë njoftuar për vendimet e marra nga vendimmarrësit, duke pasur mundësinë e ankesës. Gjithashtu, janë përkthyer ankesat dhe dokumentet e pranuar për Panelin e Ankesave në Gjykatën Supreme, si dhe janë pranuar, përkthyer dhe shpërndarë urdhrat nga Paneli i Ankesave tek palët;
- Shqyrtimi dhe ripërpunimi i vendimeve që mund të anulohen nga Paneli i Ankesave;
- Zbatimi i procedurave për riposedim, ku pas marrjes së vendimit të plotëfuqishëm, , në rastet e kërkesave për riposedim, Agjencia ka ndërmarrë masat e nevojshme për largimin eventual të shfrytëzuesve të paligjshëm.
- Gjatë vitit 2024, Agjencia ka vazhduar të administrojë dhe inspektojë rregullisht **11,386 prona** nën administrimin e saj. Për më tepër, në rastet kur bartësit e të drejtës pronësore kanë vendosur për riposedim, Agjencia u ka ofruar mbështetje për realizimin e kësaj të drejte ligjore;
- Mbyllja e kërkesave të implementuara që janë referuar për mbyllje, duke siguruar rregullsinë në lidhje me afatet kohore dhe procesin e rregullt, si dhe duke adresuar korigjimet e nevojshme tek njësitë përkatëse;
- Dëbimi i shfrytëzuesve të paligjshëm nga pronat përkatëse sipas kompetencave ekzekutive të Agjencisë;
- Bashkëpunimin me Gjykatat Themelore në mënyrë që të shmangen vendimet paralele për kërkesat duke iu raportuar rregullisht Gjykatave Themelore rreth kërkesave të shqyrtuara nga KKPK-ja dhe KKPB-ja sipas kërkesës së tyre;
- Dërgimi i kallëzimeve penale në Prokurori dhe pjesëmarrja në seancat e Gjykatave Themelore sipas nevojës;

- Vazhdimi i procesit të ndërmjetësimit në rastet që janë duke u zhvilluar, përfshirë lëndët e reja të pritshme;
- Negocimi, përditësimi dhe nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit me Policinë e Kosovës në lidhje me aktivitetet e zbatimit të AKKVP.

Gjatë periudhës raportuese, janë arritur edhe synime tjera operative nga fusha e financave, burimeve njerëzore, prokurimit dhe nga fusha e mbështetjes administrative, të cilat janë paraqitur specifikisht në kapitujt përkatës të këtij raporti.

5.3. NJOFTIMI PËR KËRKESAT

Njoftimi për kërkesat është një proces që mbikëqyret nga Njësi i Informimit, në bashkëpunim me stafin e Zyrave Regjionale. Dispozitat e legjislacionit në fuqi e rregullojnë dhe trajtojnë pjesëmarrjen e palëve dhe sigurojnë që procedurat përkatëse të procedimit të kërkesave dhe vendimmarrja mbi to të përmbushin standardet e kërkuara të procesit të rregullt dhe procedurave të paanshme. Kjo ka për qëllim sigurimin që palët me interes ligjor në pronën e kërkuar të njoftohen për kërkesën dhe të kenë mundësinë për të marrë pjesë në procedura.

Përmes Qendrës së Thirrjeve të Njësitit të Informimit, është realizuar kontaktimi dhe njoftimi i palëve në procedurë për vendimet dhe çështjet e tjera procedurale-administrative.

5.4. VERIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Gjatë vitit 2024 nevoja për verifikimin e dokumenteve ka qenë e përqendruar kryesisht në kërkesat dhe nevojat e njërive të Agjencisë.

Gjatë periudhës raportuese statistikave të verifikimit janë si më poshtë:

Gjilan	Pejë	Prishtinë	Prizren	Mitrovicë	Gjithsejtë
160	156	22	68	20	426

5.5. VENDOSJA E KËRKESAVE NGA KKPK

Gjatë periudhës së raportimit është mbajtur një seancë e Komisionit, ku janë trajtuar pesë (5) kërkesa për shfuqizim të vendimeve, të cilat janë pranuar nga Sekretaria Ekzekutive. Me këtë rast, Komisioni, përmes një rezolute, ka vendosur të shfuqizohen të pesë (5) vendimet dhe t'i kthehen Sekretarisë për ri-procedim. Nga ana tjetër, Ekipi Mbështetës i Komisioneve ka:

- pranuar 7 kërkesa nga Zyra e Implementimit për sqarime shtesë, nëse duhet të korrigjohen vendimet individuale. Pas shqyrtimit të tyre, Ekipi Mbështetës i Komisioneve është përgjigjur se vendimet duhet të korrigjohen, të cilat pastaj shqyrtuar dhe paraqitur në aplikacionin e KKPK. Pas shqyrtimit të kërkesave, të gjitha janë korrigjuar.

- kryer kontrollin e cilësisë dhe ka bere krahasimin e te gjitha vendimeve individuale me vendimet grupore.

Konfirmimi i të drejtës pronësore nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për t'iu kthyer posedimin e pronës paraqitësve të suksesshëm të kërkesave kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme. KKPK-ja kur e konfirmon të drejtën pronësore mund të urdhërojë gjithashtu riposedimin e pronës në favor të paraqitësit të kërkesës dhe të japë edhe urdhra tjerë pasues nëse e sheh të nevojshme për t'ia mundësuar bartësit të së drejtës pronësore të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore. Prandaj, KKPK-së në mënyrë të qartë i janë dhënë kompetencat për të siguruar pajtueshmëri me detyrimet ligjore të vendimeve në favor të bartësve të së drejtës pronësore/pronarëve.

Vendimet e KKPK-së janë ligjërisht detyruese, pa cenuar të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës, si parashihet me legjislacionin në fuqi, i cili parasheh gjithashtu llojin e urdhërave që KKPK-së i lejohet t'i lëshojë.

Vlen të theksohet se gjatë vitit raportues është pranuar një (1) ankesë ndaj vendimit përfundimtar për kompensim, ndërsa janë shqyrtuar tri (3) ankesa nga Gjykata Supreme.

5.6. SHPËRNDARJA E VENDIMEVE TË KKPK-SË DHE AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS SUPREME

Procedura e shpërndarjes së vendimeve të KKPK-së dhe, në rast të ankesës, edhe të Gjykatës Supreme, si hap i parë në procesin e zbatimit, përfshin Qendrën e Thirrjeve të Agjencisë, e cila kontakton palët në kërkesë për ti informuar se vendimi është lëshuar dhe mund të merret. Poashtu, caktohet takimi për dorëzimin e vendimeve në Zyrat e Agjencisë, sipas preferencave të tyre. Pas dorëzimit të vendimit, palët mund të parashtrojnë ankesë brenda afatit prej 30 ditësh në Gjykatën Supreme, përmes Sekretarisë Ekzekutive.

Për më tepër, ky takim për dorëzimin e vendimit ofron mundësinë për të informuar paraqitësit e kërkesave mbi procesin e implementimit dhe për tu njoftuar nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave nëse dhe si do të dojnë të zbatohet vendimi.

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka tentuar të vazhdojë me dërgimin e vendimeve dhe aktgjykimeve në Republikën e Serbisë, përmes Ministrisë së Drejtësisë, Departamentit për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare. Mirëpo, nga ky institucion është konfirmuar se komunikimi aktualisht është ndërprerë dhe nuk ka mundësi të përcillen vendimet, duke pritur një njoftim të ardhshëm.

Gjatë periudhës së raportimit (2024), Agjencia ka shpërndarë gjithsej 27 vendime të KKPK-se, nga të cilat 23 janë shpërndarë paraqitësve të kërkesave dhe 4 palëve përgjegjëse.

Gjithashtu, 4 aktgjykime të Gjykatës Supreme u janë shpërndarë palëve, prej tyre: dy paraqitësve të kërkesave, një palës së interesuar dhe një palës përgjegjëse.

Numri i shpërndarë i vendimeve të KKPK-së gjate vitit 2024	
Vendime të shpërndara paraqitësve të kërkesave	23
Vendime të shpërndara shfrytëzuesve aktualë të pronave	0
Vendime të shpërndara palëve përgjegjëse	4
Numri i shpërndarë i Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme gjate vitit 2024	
Aktgjykime të shpërndara paraqitësve të kërkesave	2
Aktgjykime të shpërndara palëve të interesuara	1
Aktgjykime të shpërndara palëve përgjegjëse	1

5.7. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË KKPK-SË

Sipas legjislacionit në fuqi, ankesat kundër vendimeve të KKPK-së paraqiten në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive, e cila është gjithashtu përgjegjëse për shpërndarjen dhe zbatimin e aktgjykimeve. Procedurat dhe formati që përdoren për paraqitjen e ankesave janë përcaktuar në marrëveshje me Panelin e Ankesave të Gjykatës Supreme. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme janë të formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohen përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme ligjore; ato bëhen të ekzekutueshme pesëmbëdhjetë ditë pasi të bëhet njoftimi i palëve.

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka pranuar 1 ankesë kundër vendimeve të KKPK-së e cila është dërguar në Gjykatën Supreme, si dhe janë shqyrtuar 3 ankesa nga Gjykata Supreme. Ankesa në pritje për shqyrtim nga Gjykata Supreme janë gjithsej 6.

Numri i ankesave të pranuar kundër vendimeve të KKPK-së gjate vitit 2024	
Ankesa të pranuar kundër vendimeve të KKPK-së	1
Ankesa të shqyrtuara nga Gjykata Supreme	3
Ankesa në pritje për shqyrtim nga Gjykata Supreme	6

5.8. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KKKP-SË

Sipas legjislacionit në fuqi, zbatimi efikas i vendimeve përfundimtare për kërkesat arrihet përmes masave që përfshijnë por nuk janë të kufizuara, në vendosjen e pronës nën administrimin e Agjencisë, dëbimin, shkatërrimin e strukturave të paligjshme dhe marrëveshjet për qiranë. Zbatimi i vendimeve të KKKP-së është përgjegjësi e Sekretarisë Ekzekutive e cila kryhet nga Njësi i Implementimit. Aktivitetet e zbatimit që përfshijnë dëbimin e shfrytëzuesve të paligjshëm kryhen nga Njësi i Dëbimeve të Agjencisë.

Gjatë periudhës raportuese, janë zbatuar gjithsejtë 367 kërkesa, prej cilave 275 kërkesa, janë dërguar për mbyllje me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, 66 kërkesa janë dërguar për mbyllje për shkak të mosbashkëpunimit, 15 kërkesa janë dërguar për administrim në Njësinë për Administrimin e Pronave, 8 kërkesa të hedhura poshtë/refuzuara me vendimin e Komisionit, për të cilat brenda afatit ligjor Agjencia nuk ka pranuar ankesë, si dhe 3 ankesa të hedhura poshtë me Vendim të Gjykatës Supreme.

Numri i vendimeve të KKKP-së , të zbatuara gjatë vitit 2024	
Kërkesa të mbyllura me kërkesën e paraqitësit të kërkesës	275
Kërkesa të mbyllura si rezultat i mos bashkëpunimit	66
Kërkesat dërguar Njësitit për Administrimin e Pronave	15
Kërkesa të hedhura poshtë - refuzuar me vendim të Komisionit	8
Kërkesa të hedhura poshtë me Vendim të Gjykatës Supreme	3

5.9. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KKKP-SË

Agjencia ka gjithashtu mandat për të zbatuar kërkesat pronësore banesore që kanë qenë në pritje më 4 mars 2006, dhe për të menaxhuar dosjet e pronave të administruara nga DÇPB-ja. Për të ushtruar këtë aspekt të mandatit të saj, Agjencia i janë dhënë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e DÇPB-së lidhur me zbatimin e vendimeve të pazbatuara nga Drejtoria, si dhe administrimin e pronave që ishin në administrimin e Drejtorisë.

Përveç kësaj, ka pasur një numër kërkesash të paraqitura në DÇPB dhe të vendosura nga KKKP-ja, ku paraqitësit e suksesshëm të kërkesave nuk kanë kërkuar zbatimin e vendimeve në atë kohë, dhe DÇPB-ja i kishte mbyllur këto raste pa zbatimin fizik. Si pasojë, Agjencia gjatë vitit 2024 ka pranuar një (1) kërkesë për riposëdime të paraqitur nga paraqitësi i suksesshëm i kërkesës. Duke pasur parasysh se paraqitësit e kërkesave në të gjitha këto raste kanë pasur të drejtë për dëbim sipas vendimit të KKKP-së, Agjencia ka vepruar në përputhje me këtë.

Gjatë periudhës raportuese, në total janë lëshuar 32 urdhra dëbimi, prej të cilëve 28 me kërkesë për riposedit në lidhje me vendimet e KKPb-së dhe 4 urdhra për dëbim në lidhje me vendimet e KKPb-së.

5.10. ADMINISTRIMI I PRONËS

Legjislacioni në fuqi e autorizon Agjencinë të administrojë pronat në secilën nga këto rrethana:

- Me marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e kërkesës
- Me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, sipas vendimit të Komisionit që vërteton të drejtën pronësore
- Pas largimit të shfrytëzuesit aktual, në rast se paraqitësi i kërkesës nuk mund ta riposedoj pronën pas njoftimit për lirim të pronës

Në bazë të ligjit, administrimi i pronave ka qenë i kufizuar deri më datë 18 maj 2018. Megjithatë, pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit Nr.551/2017, në të cilat është kërkuar zgjatja e afatit ligjor për administrimin e pronave, Qeveria e Kosovës ka miratuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për AKKVP-në. Megjithatë, Agjencia ka vazhduar, në përputhje me rregullat dhe procedurat e brendshme, të bëjë inspektimin e pronave edhe pas datës 18 maj 2018, për të parandaluar keqpërdorimin e këtyre pronave.

Gjatë vitit raportues ka pasur angazhime të shumta për administrimin e pronave dhe zbatimin e skemës vullnetare të qirasë.

Gjithsejtë 11,386 prona janë nën administrim të Agjencisë. Në 29 raste bartësi i së drejtës pronësore/pronari ka paraqitur kërkesë për ndërprerjen e administrimit.

Si pjesë e mandatit të saj të trashëguar nga DÇPB, Sekretaria Ekzekutive administron edhe 265 prona të braktisura të banimit që ishin marrë "ex officio" nën administrim nga ish DÇPB. Agjencia është duke zbatuar një strategji me të cilën synon të identifikojë bartësit e ligjshëm të të drejtave pronësore për t'u mundësuar dorëzimin e këtyre pronave.

Më poshtë janë paraqitur të dhëna të ndryshme lidhur me pronat nën administrim:

Numri i përgjithshëm i pronave nën administrim:

	<i>Gjilan</i>	<i>Mitrovicë</i>	<i>Pejë</i>	<i>Prishtinë</i>	<i>Prizren</i>	<i>Gjithsejtë</i>
Bujqësore	1874	1440	3720	1165	1166	9365
Komerciale	1	7	16	9	4	37
Banesore	213	435	882	261	193	1984
Gjithsejtë	2088	1882	4618	1435	1363	11,386

Numri i përgjithshëm i inspektimeve të pronave nën administrim gjatë vitit 2024:

	<i>Gjilan</i>	<i>Mitrovicë</i>	<i>Pejë</i>	<i>Prishtinë</i>	<i>Prizren</i>	<i>Gjithsejtë</i>
Bujqësore	5076	3046	8626	2474	2639	21861
Komerciale	4	30	26	25	8	93
Banesore	541	1444	1744	466	403	4598
Gjithsejtë	5621	4520	10396	2965	3050	26552

5.11. SKEMA E QIRADHËNIES VULLNETARE

Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-010 për AKKVP-në parasheh që pronat që janë nën administrim të AKKVP-së mund të jepen me qira. Pronat të cilave u dihet pronari apo bartësi i të drejtës së pronësisë mund të jepen me qira vetëm pas pëlqimit të pronarit/bartësit të së drejtës së shfrytëzimit. Të ardhurat nga qiraja e pronës së braktisur private dhe shoqërore regjistrohen në një llogari të veçantë, në ruajtje për pronarin e vërtetë, ndërsa për pronat të cilave u dihet pronari apo bartësi i të drejtës së pronësisë, qiraja i paguhet pronarit/bartësit të së drejtës së shfrytëzimit. Agjencia, në emër të shpenzimeve të shërbimeve, i mban 10% nga shuma e qirasë.

Skema vullnetare e qiradhënies ofron burim të ardhurash minimale nga pronat për bartësit e të drejtës pronësore.

Gjatë periudhës së raportimit, Agjencia ka pranuar pagesa nga skema e qirasë për 54 prona që janë në administrim të Agjencisë.

5.12. AKTIVITETET E DËBIMEVE

Dëbimi është një nga mjetet juridike nëpërmjet të cilit realizohet zbatimi i vendimeve të plotfuqishme të Komisioneve nga Sekretaria Ekzekutive e AKKVP-së.

Ashtu si vitet e kaluara, edhe gjatë këtij viti, objektivi kryesor ka qenë zbatimi i vendimeve të plotfuqishme të lëshuara nga Komisionet kompetente të Agjencisë, ku, pas lirimit të pronave nga gjësendet dhe personat e vendosur jashtëligjshëm, është realizuar kthimi i pronës në posedim tek paraqitësit e kërkesave.

Gjatë vitit 2024, Agjencia kishte gjithsejtë 96 kërkesa fillestare për riposedim të pronës, nga të cilat janë realizuar 12 ekzekutime të urdhër-dëbimeve me mbështetje të Policisë së Kosovës.

Përderisa nga gjithsej 52 raste të proceduara për ekzekutim me mbështetje të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2024, 45 raste janë anuluar me lirim të pronës në mënyrë vullnetare ose palët kanë hyrë në marrëveshje kontraktuale. Në fund të vitit 2024, njësia e zbatimit ka pasur urdhra dëbimi në pritje për gjithsej 41 raste.

5.12.1 LIRIMI I PRONAVE NË REGJIONIN E MITROVICËS/KOMUNAT E VERIUT

Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e situatës së sigurisë në veriun e Kosovës, për një kohë të gjatë Agjencia ka qenë e kufizuar në zbatimin e vendimeve sipas mandatit të saj. Pas ndryshimeve të ndodhura në aspektin e sigurisë në këtë pjesë të Republikës së Kosovës dhe pas takimit informues të Agjencisë me qytetarët në Mitrovicën e Veriut në Europe House, të lehtësuar nga ekipi i Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së në Kosovë si dhe për të garantuar respektimin e të drejtave pronësore dhe përmbushjen e mandatit të saj ligjor, janë liruar në mënyrë vullnetare 43 prona. Pas verifikimit dhe konstatimit të bërë nga Agjencia, këto prona u janë kthyer pronarëve të ligjshëm.

Roli dhe angazhimi maksimal i Agjencisë në procesin e lirit të pronave përfshin një sërë aktiviteteve dhe procedurash, të cilat fillojnë me njoftimin e shfrytëzuesve të paligjshëm dhe përfundojnë me lirin e pronave, qoftë në mënyrë vullnetare, apo përmes mjeteve ligjore të ndërmarra nga Agjencia.

Bashkëpunimi me Policinë

Për të rritur efikasitetin në finalizimin e procedurave të ekzekutimit të urdhër-dëbimeve, me iniciativë të të dy institucioneve, është ripërtërirë marrëveshja e bashkëpunimit mes Policisë së Kosovës dhe AKKVP-së. Ky bashkëpunim është thelbësor për procesin e aplikimit të mjetit juridik, veçanërisht në veri të rajonit të Mitrovicës, ku ka pasur ngecje në realizimin e këtij procesi gjatë viteve të kaluara.

Numri i përgjithshëm i urdhërave për dëbim dhe i aktiviteteve tjera është si më poshtë:

Ekzekutimi i Urdhrave për Dëbim							
	Gjilan	Pejë	Prishtinë	Prizren	MI/Jug	MI/Veri	Gjithsejtë
Urdhër Dëbimet e pranuar	2	7	1	3	5	15	33
Urdhër Dëbimet e Planifikuara	2	5	0	4	1	0	12
Urdhër Dëbimet e Ekzekutuara	2	5	0	4	1	0	12
Uzurpimet pas Ekzekutimit të Urdhërit (Ri-uzurpimet)	1	0	0	1	0	0	2
Urdhër Dëbimet të pezulluara	0	0	0	0	0	0	0
Urdhër Dëbimet të anuluar	0	3	2	0	0	40	45
Urdhër Dëbimet në pritje për ekzekutim 2024 :	Gjilan	Pejë	Prishtinë	Prizren	MI/Jug	MI/Veri	Gjithsejtë
Riposedim	0	8	7	0	7	18	40
Skema e qirasë	1	0	0	0	0	0	1
GJITHSEJTË DËBIME NË PRITJE NË AKKVP	1	8	7	0	7	18	41

Përfaqësimet ne Gjykata dhe Institucione tjera	Gjilan	Pejë	Prishtinë	Prizren	MI/Jug	MI/Veri	Gjithsejtë
Thirrjet e pranuar për Seancë nga Gjykatat Themelore	0	11	8	3	4	0	26
Pjesëmarrja në Seanca në Gjykatat Themelore	0	11	8	3	4	0	26
Vendimet e Pranuar nga Gjykatat Themelore/ Prokuroritë	0	6	10	0	1	0	17
Dokumentet e paraqitura në Gjykata Themelore/Prokurori/Institucione tjera	0	6	10	0	2	0	18
Kallzime penale/Ri-uzurpim i pronës	1	0	0	1	0	0	2

5.13 RASTET E RI-UZURPIMIT SERIK

Në vitin 2024 janë shënuar 2 raste të ri-uzurpimit, 1 në regjionin e Gjilanit dhe 1 ne regjionin e Prizrenit. Siç dihet, uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme dhe hyrja e pa autorizuar në pronën e huaj përbëjnë vepër penale sipas neneve 320 dhe 406 të Kodit Penal të Kosovës nr.06/L074. Për të gjitha këto raste, Agjencia paraqet kallëzime penale në prokuroritë përkatëse.

Gjatë vitit 2024, në prokuroritë përkatëse janë iniciuar 2 raste të ri-uzurpimit. Numri i përgjithshëm i rasteve të tilla të iniciuara ndër vite ka arritur në 499 raste, prej tyre, 362 raste janë vendosur nga gjykata komunale/themelore përkatëse, ndërsa 137 raste janë ende në procedurë në prokuroritë apo gjykatat themelore.

Sa u përket kontesteve të natyrës Civile, numri i përgjithshëm i rasteve është 62, prej të cilave 25 janë përfunduar, ndërsa 37 janë në procedurë.

5.14. MBYLLJA E KËRKESAVE

Pas zbatimit të një kërkesë të vendosur, ajo kërkesë duhet të mbyllet dhe ky veprim ndërmerret nga Njësia e Mbylljes së Lëndëve. Qëllimi i fazës së mbylljes është të sigurojë që mekanizmi i Agjencisë është respektuar në të gjitha fazat e procesit, veçanërisht sa i përket afateve dhe procesit të rregullt, duke adresuar gabimet aty ku është e nevojshme dhe e mundshme. Pas vlerësimit se rregullat dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe Procedurat Standarde Operative janë respektuar, kërkesa mbyllet.

Gjatë vitit 2024, janë mbyllur gjithsej 305 kërkesa, të ndara sipas kategorive më poshtë:

- 50 kërkesa të mbyllur nga kategoria “Mosbashkëpunim – Paraqitësi i kërkesës është njoftuar për vendimin”;
- 238 kërkesa të mbyllura pa zbatim;
- 5 kërkesa të mbyllura pasi janë tërhequr nga paraqitësi i kërkesës;

- 4 kërkesa të mbyllura pasi Gjykata Supreme, pas ankesës, ka konfirmuar vendimin e KKPK-së për hedhje poshtë të kërkesës;
- 2 kërkesa të mbyllura nga kategoria “Mosbashkëpunim – Paraqitësi i kërkesës nuk e ka marrë vendimin final”;
- 1 kërkesë e mbyllur pasi Gjykata Supreme, pas ankesës, ka konfirmuar vendimin e KKPK-së për refuzim të kërkesës;
- 3 kërkesa të mbyllura me refuzim të kërkesës për administrim;
- 2 kërkesa të mbyllura pasi janë hedhur poshtë nga KKPK dhe pasi ankesat janë hedhur poshtë nga Gjykata Supreme si jashte afatit;

5.15. NDËRMJETËSIMI

Në bazë të Ligjit Nr.05/L-010 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-052 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe në përpjekje për të zbatuar vendimet e KKPK-së, para se të përdoret mjeti i zbatimit për shkatërrimin e strukturave/objekteve të paligjshme, Agjencia ka filluar të bëjë ndërmjetësimin mes palëve.

Nga gjithsej 88 raste të identifikuara me struktura të paligjshme të ndërtuara nga shfrytëzuesit e paligjshëm në pronat e paraqitësve të kërkesave, të cilëve me vendim të Komisionit për Kërkesa Pronësore u është njohur e drejta e pronësisë, Agjencia ka nisur procesin e ndërmjetësimit si mjet për arritjen e një marrëveshje miqësore në mes palëve.

Në 50 raste, me sukses është arritur marrëveshja në mes të palëve, qoftë përmes ndërmjetësimit në Agjenci apo në formë të marrëveshjes jashtë Agjencisë. Në 23 raste, ky proces ka rezultuar i pasuksesshëm apo palët kanë refuzuar ndërmjetësimin si mjet për arritjen e marrëveshjes ndërsa aktualisht, gjatë periudhës raportuese, me kërkesë të palëve, ndërmjetësimi ka rifilluar dhe është në proces në 14 raste.

Gjate vitit raportues, Agjencia ka zbatuar 4 vendime të Komisionit për Kërkesa Pronësore si rezultat i ndërmjetësimit dhe marrëveshjeve në mes të palëve.

Nga stafi i Agjencisë, 18 zyrtarë janë trajnuar si ndërmjetësues dhe të gjithë e kanë kryer trajnimin për ndërmjetësim me mbështetjen e Qeverisë Britanike. Bazuar në kornizën ligjore në fuqi, për çdo rast caktohen dy ndërmjetësues: një nga rajoni ku gjendet prona dhe një nga Zyra Regjionale më e afërt me vendbanimin e paraqitësit të kërkesës. Aktualisht, në proces janë përfshirë zyrat Regjionale të Prishtinës, Pejës, Prizrenit dhe Gjilanit.

5.16. AKTIVITETE MBËSHTETËSE ADMINISTRATIVE

5.16.1 NJËSITI I ADMINISTRATËS

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka qenë e angazhuar maksimalisht në sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetit në të gjitha aktivitetet e veta administrative mbështetëse në përputhje me rregullativën ligjore.

Gjatë vitit 2024, me sukses janë ofruar shërbime logjistike, shërbime transporti, menaxhim i ndërtesave, shërbime të sigurisë, menaxhimi i aseteve dhe depove, furnizimi dhe arkivimi për Zyrën Qendrore dhe zyrat regjionale.

Agjencia përdor teknologji bashkëkohore, dhe përpunimi i kërkesave është i kompjuterizuar në masë të madhe. Njësiti i TI-së është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes teknike dhe garanton një mjedis të qëndrueshëm elektronik të punës. Për të lehtësuar përpunimin e kërkesave, zhvillimi dhe menaxhimi i të dhënave dhe aplikacioneve bëhet në bashkëpunim me përdoruesit e fundit. Përditësimi dhe avancimi i aplikacioneve realizohet nëpërmjet identifikimit dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja. Njësiti i TI-së është gjithashtu përgjegjës për trajnimin e stafit për përdorimin e aplikacioneve dhe pajisjeve softuerike.

5.16.2 AKTIVITETET E PROKURIMIT

Gjatë vitit 2024 Njësiti i Prokurimit ka arritur me sukses që nga 56 kërkesa të prokurimit të pranuar, t'i trajtojë të gjitha, të ndara sipas procedurave më poshtë:

Proceset e prokurimit të zhvilluara sipas procedurave më:

- Prokurimet me Vlera të Mëdha (>125,000€), gjithsej një (1) proces i prokurimi
- Prokurimet me Vlera të Mesme (10,000€ - 125,000€), gjithsej 3 (tri) prokurime të zhvilluara.
- Prokurimet me Vlera të Vogël (1,000€-10,000€), gjithsej 21 (njetzenje) prokurime të zhvilluara.
- Prokurimet me Vlera Minimale (100€ -1,000€), gjithsej 21 (njetzenje), prokurime të zhvilluara.
- Procedure e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, gjithsej 1 (një) proces i zhvilluar;
- Prokurimet e Anuluara, 5 (pese) procese.
- Prokurimet e Ankimuar, 1 (nje) proces i cili është vendosur nga OSHP, në favor të AKKVP-së.

Të gjitha aktivitetet e prokurimeve janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimi Publik 04/L042, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 05/L-068, i cili ka hyrë në fuqi më 21 janar 2016; si dhe Rregulloren për Prokurimi Publik 001/2022, e cila ka hyrë në fuqi më 01 nëntor 2022.

Në,nëntor të vitit 2024, ka hyrë në fuqi Rregullorja 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik.

Po ashtu, të gjitha njoftimet për kontratë (publikimet) për proceset e prokurimit me *vlera të mëdha, të mesme, të vogla*, dhe minimale janë publikuar në ueb faqen e KRPP-së. Kjo nënkupton se Autoriteti Kontraktues i AKKVP-së ka qenë transparent dhe i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në proceset e prokurimit të iniciuara nga AK i AKKVP-së.

Gjatë vitit 2024, AK i AKKVP-së, në përputhje me nenin 9.4 dhe vendimit të Qeverisë nr. 13/148 (i përmendur më lartë), ka vazhduar me përdorimin e kontratave të centralizuara, të zhvilluara nga AQP, për prokurimet si më poshtë:

- Furnizim me karburante
- Furnizim me material zyrtar
- Shërbime fotokopjimi, skanimi, printimi (fotokopje me qira)
- Furnizim me goma për automjete
- Furnizim me letër për fotokopje
- Furnizim me ujë të pijshëm
- Furnizim me pajisje të IT-së
- Furnizim me inventar/mobilie për zyra
- Furnizim me vetura zyrtare

Njësitë e Prokurimit, në koordinim të ngushtë me Njësinë e Financave dhe Njësinë e Administratës, ka arritur suksesshëm të procedojë të gjitha urdhërblerjet në përputhje me sistemin e menaxhimit të financave publike (SIMFK), dhe brenda afatave kohore të caktuara nga Ministria e Financave.

Stafi i Njësitit të Prokurimit është i licencuar me Licencë Valide nga Institucionet përkatëse, si IKAP dhe KRPP.

5.17 VEPRIMTARITË INFORMATIVE DHE SHPËRNDARJA E INFORMATAVE PËR PUBLIKUN

5.17.1. TRANSPARENCA DHE INFORMIMI

Gjatë periudhës së raportimit, Agjencia ka ndërmarrë një sërë iniciativash për të qenë më afër palëve kërkuuese, OJQ-ve, organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si dhe publikut të gjerë.

Agjencia ka vazhduar të ofrojë shërbimepërmes Qendrës së Thirrjeve, si dhe linjës telefonike dhe e-mailit (Kpcva.Mailbox@rks-gov.net) të dedikuara për informata, duke mundësuarqë palët të informohen shpejt mbi statusin aktual të kërkesave të tyre dhe të marrin informata për procesin dhe procedurat që zhvillohen në Agjenci.

Gjithashtu, Agjencia ka vazhduar me përditësimin e webfaqes së saj zyrtare, duke ofrruar një gamë të gjerë informacioneshdhe statistikash lidhur me pranimin e kërkesave, vendimet e Komisionit, shpërndarjen dhe zbatimin e vendimeve të Komisionit, menaxhimin e dosjeve të pronave nën administrim dhe skemën e qiradhënies.

Gjatë vitit 2024, Agjencia ka qenë pranishme në media. Përfaqësues e saj kanë dhënë intervista në gazeta, radio dhe televizion, duke trajtuar çështjet pronësore. Përmes Njësitit të Informimit, Agjencia ka ofruar informata dhe statistika të përditësuara për aktivitetet dhe politikat e saj.

Në dhjetor të vitit 2024, Agjencia ka nisur një fushatë informuese mbi mundësinë e parashtrimit të kërkesave për njohje ligjore të të drejtave joformale pronësore, në kuadër të mandatit për informalitetin.

Agjencia ka emëruar zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare, duke garantuar qasje për të gjitha palët e interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2024, nëpunësit e Njësitit të Informimit kanë ndihmuar në përgatitjen e raporteve të rregullta (kryesisht 3 mujore) për PKZMSA, si dhe për organizata dhe institucione tjera relevante.

15.7.2 BASHKËPUNIMI NË MES AGJENCIVE

Në përpjekje për t'iu ofruar informata institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, Agjencia ka realizuar takime të rregullta me aktorë tjerë në fushën e të drejtave pronësore, me qëllim rritjen e vetëdijes për punën e saj dhe rëndësinë në ndërtimin e paqes, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit. Këtu përfshihen, ndër të tjera, UNHCR; OSBE dhe OJQ të ndryshme. Agjencia ka zhvilluargjithashtu takime me zyrtarë të Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës. Përveç kësaj, zyrtarët e Agjencisë kanë marrë pjesë në takime, punëtori dhe seminare, si brenda ashtu dhe jashtë Kosovës, të organizuara nga organizata dhe OJQ që merren me çështjet e të drejtavepronësore dhe procesin e kthimit.

15.7.3 ROLI I AKKVP-SË NË PROJEKTIN E RINDËRTIMIT TË KADASTRËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka kontraktuar rindërtimin e kadastrës për 115 zona kadastrale, në kuadër të projektit REGIP të financuar nga Banka Botërore. Përfshirja e KPCVA përfshin:

- Verifikimi i të drejtave pronësore për të zgjidhur mospërputhjet në të dhënat kadastrale
- Vendimmarrja mbi kërkesat për pronat e kontestuara nëpërmjet Komisionit për Kërkesa Pronësore (KKP)
- Mbështetje për pronarët e zhvendosur të pronave në vërtetimin e pronësisë
- Koordinimi teknik me AKK-në për të siguruar që përditësimet kadastrale pasqyrojnë pronësinë ligjore

6. SFIDAT E INSTITUCIONIT/REKOMANDIMET

6.1. SFIDAT E VITIT RAPORTUES

Gjatë vitit 2024, Agjencia është ballafaquar me një numër sfidash, të cilat janë renditur më poshtë si procese kyçe që kanë ndikim të drejtpërdrejt në funksionimin e Agjencisë. Këto procese janë çështje thelbësore për qëndrueshmërinë e Agjencisë dhe zhvillimin e mëtjeshëm të Agjencisë.

6.1.1. PROCESI I KTHIMIT TË DOKUMENTEVE ORIGINALE TË SKANUARA KADASTRALE

Numri i përgjithshëm i dokumenteve kadastrale të skanuara, të cilat pritet të kthehen nga Serbia është mbi 4 milionë. Sipas marrëveshjes së Brukselit, këto dokumente do të pranohen nëpërmjet PPBE-së -proces i cili ende nuk ka filluar. Qeveria do të koordinojë procesin e dorëzimit të këtyre dokumenteve, si dhe do të bëjë monitorimin e përputhshmërisë së procesit me marrëveshjen e Brukselit për Kadastër. Gjatë vitit raportues, Bordi mbikqyrës i Agjencisë i ka derguar shkresë zyrtare perfaqesuesit të posacëm të BE-së për bisedime Kosove-Serbi, z.Lajcak, ku është kërkuar që në kuadër të bisedimeve të kërkohej nga pala serbe që të fillojë me zbatimin e marreveshjes për regjistrat kadastralë.

6.1.2. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KKKP-SË DUKE APLIKUAR MJETIN JURIDIK TË SHKATËRRIMIT TË STRUKTURAVE TË PALIGJSHME

Shkatërrimi i strukturave të paligjshme është një prej mjeteve për zbatimin e vendimeve të KKKP-së. Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.01/2020 Për Përcaktimin e Procedurave për Shkatërrimin e Strukturave të Paligjshme, Agjencia ka filluar me aplikimin e këtij mjeti. Prej të gjitha rasteve të identifikuara me struktura të paligjshme, Agjencia, në përputhje me udhëzimin administrativ, ka njoftuar 55 paraqitës të suksesshëm të kërkesave në lidhje me mundësinë e zbatimit të vendimit, përmes mjetit juridik shkatërrimi i strukturave të paligjshme.

Megjithatë, deri me tani, ky mjet është zbatuar vetëm në një (1) rast, pasi palët kanë zgjedhur mundësinë e ri-ndermjetesimit si mjet për të arritur marrëveshje. Gjatë vitit raportues, nuk është pranuar asnjë kërkesë për zbatimin e vendimeve përmes mjetit juridik të shkatërrimit të strukturave të paligjshme. Me Ligjin e Buxhetit të vitit 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndarë Agjencisë për këtë qëllim 30.000€, edhe pse kjo shumë nuk mbulon të gjitha nevojat për zbatimin e këtyre vendimeve.

Pavarësisht nga përgatitjet e nevojshme që po kryhen dhe faktit se këto raste janë shumë të ndjeshme, pasi ndër të tjera, këto prona ishin blerë në bazë të dokumenteve të falsifikuara, përkatësisht nga persona që kanë falsifikuar autorizimet, Agjencia e konsideron jashtëzakonisht të rëndësishme mbështetjen nga institucionet, përfshirë edhe Qeverinë, për një proces të suksesshëm.

6.1.3 PERSONELI

Për nevoja të realizimit sa më të suksesshëm të mandatit të Agjencisë, sigurimi i stafit të kualifikuar, si nga fusha e të drejtës pronësore, ashtu edhe nga ajo kadastrale dhe e TI-së, është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Për ta realizuar këtë, Agjencia duhet të ofrojë paga konkurruese si për stafin aktual, ashtu edhe për stafin e ri. Prandaj, Agjencia parasheh vështirësi në këtë drejtim për shkak të pagave jo konkurruese.

7. FINANCIMI DHE BUXHETI

7.1 FINANCIMI

Çështjet buxhetore dhe financiare të Agjencisë janë përgjegjësi e Njësisë së Financave të Agjencisë. Edhe pse Agjencia ka mandat për të përmbushur një nga funksionet kryesore të sundimit të ligjit në Kosovë, gjatë vitit 2024 nuk ka pasur financim nga donatorët siç ka ndodhur në të kaluarën dhe nuk ka pasur financim të mjaftueshëm për nevojat e Agjencisë sidomos për nivelin e pagave për stafin e saj, për ndryshim nga Agjencitë tjera qeveritare të cilat kanë nivelet e duhura të financimit qendror.

Buxheti i Kosovës për vitin 2024 është miratuar më 14 dhjetor 2023 përmes Ligjit të Buxhetit nr. 08/L-260.

Agjencia gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit 2024 ka adresuar në Ministrinë e Financave çështjen e diferencës ndërmjet kërkesës buxhetore të Agjencisë dhe kufijve buxhetorë të propozuar në Qarkoret buxhetore për vitin 2024, me arsyetimin e duhur, për të siguruar fondet e nevojshme për të mbuluar mungesën në mallra dhe shërbime dhe për investime kapitale. Kërkesa për të mbuluar mungesën në mallra dhe shërbime është aprovuar pjesërisht.

Agjencisë i janë ndarë 2,613,968€ nga Buxheti i Kosovës për vitin 2024.

Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur ndryshime përmes të rishikimit buxhetor në gjashtëmuor, ndërsa në bazë të shkresave të Ministrisë së Financave për kursime dhe transfere mes kategorive, si dhe Vendimeve të marra nga Qeveria e Kosovës, në fund të vitit 2024 janë bërë disa ndryshime në buxhetin final të Agjencisë. Bazuar në këto ndryshime, buxheti final ishte 2,369,946€, dhe ky zvogëlim i buxhetit ka të bëjë me zvogëlimin e buxhetit në kategorinë e pagave.

Gjatë periudhës së raportimit, Agjencia nuk ka marrë donacione siç ka ndodhur në vitet e kaluara.

7.2. ZBATIMI I BUXHETIT

Bashkëngjitur si shtojcë e raportit është tabela Buxheti i AKKVP-së i kërkuar për vitin 2024, ndërsa më poshtë është i prezantuar si total:

Paga dhe Mëditje:	1,490,247
Mallra dhe Shërbime	795,199
Shërbime Komunale:	48,523
Investime Kapitale:	280,000
Gjithsejtë:	2,613,968

Duke marrë parasysh nevojat e rishikuara të AKKVP-së dhe ndryshimet e bëra me vendimet e Qeverisë, bashkëngjitur si **Shtojca D** gjendet buxheti i rishikuar final i AKKVP-së për vitin 2024, me alokimet e rishikuara të paraqitura si në vijim:

Paga dhe Mëditje:	1,246,224
Mallra dhe Shërbime:	795,199
Shërbime Komunale:	48,523
Investime Kapitale:	280,000
Gjithsejtë:	2,369,946

Bashkëngjitur si **Shtojca E** është Pasqyra e Buxhetit të AKKVP-së për vitin 2024, e cila tregon mënyrën e shpenzimit të buxhetit. Si përmbledhje, shuma e përgjithshme e përvetësuar nga BRK për vitin 2024 ishte 2,369,946€, prej së cilës janë shpenzuar 2,245,975€. Shuma e mbetur prej 123,971€, e cila nuk ka mundur të shpenzohet brenda vitit 2024, është shkaktuar nga diferenca ndërmjet shumës së planifikuar dhe shumës aktuale të shpenzuar, kryesisht për mallra, komunali dhe investime kapitale.

Përqindja e shpenzimeve nga mjetet e ndara nga BRK-së për buxhetin e AKKVP-së për vitin 2024 është 94%.

8. ADRESIMI I KOMENTEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2024, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë për vitin 2023. Sipas opinionit të ZKA, pasqyrat financiare të Agjencisë për vitin 2023 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (Opinion i Pamodifikuar³).

Për fushat siç janë: pasqyrat vjetore financiare, të hyrat, pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet jo përmes prokurimit, subvencionet dhe transferet, detyrimet, trajtimi i borxheve dhe sistemi i auditimit të brendshëm, ZKA nuk ka çështje të ngritura dhe ka realizuar një rekomandim nga viti paraprak që ka të bëjë me hartimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

³Termi “opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin “opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionet paraprake të Raportit Vjetor të Auditimit. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200).

9. NGJARJET KRYESORE GJATË VITIT 2024

JANAR

- AKKVP-së i është aprovuar shuma prej 2,613,968 Euro nëpërmjet Ligjit për Buxhetin e Kosovës, për vitin 2024

MARS

- Mbajtja e mbledhjes së Bordit Mbikëqyrës të AKKVP-së. Miratimi i Raportit vjetor 2023 të AKKVP-së dhe i Rregullores për standardet e organizimit dhe sistematizimit të brendshëm të vendeve të punës të AKKVP-së

MAJ

- Pjesëmarrje në konferencën e Bankës Botërore për Tokën në Washington DC të SHBA-së
- Takim me udhëheqësin e projektit REGIP në kuadër të Bankës Botërore, në zyrën qendrore të Bankës Botërore, SHBA

QERSHOR

- Takim me përfaqësues të KFOR-it nga Zyra Qendrore
- Takim me përfaqësues të KFOR-it nga Carabinierët Italian
- Takim me zyrtarë të Bankës Botërore
- Takim me përfaqësuesit e OSBE-së
- Mbajtja e mbledhjes së Bordit Mbikëqyrës të AKKVP-së

KORRIK

- Takim me përfaqësuesit e EULEX-it
- Takim me kryetarin e komunës së Mitrovicës së Veriut
- Takim informues me qytetarët në Mitrovicën e Veriut i lehtësuar nga ekipi i Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së në Kosovë në Europe House

SHTATOR

- Takim me anëtarin e re të Bordit Mbikëqyrës të AKKVP-së, Ambasadorin e Republikës së Kroacisë në Republikën e Kosovës, znj. Danijela Barišić
- Takim me Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, z. Jonathan Hargreaves
- Mbajtja e mbledhjes së Bordit Mbikëqyrës të AKKVP-së

TETOR

- Takim me Ambasadorin e BE-së në Republikën e Kosovës, z. Aivo Orav

NËNTOR


- Takim me komisionerët e AKKVP-së

DHJETOR

- Mbajtja online e mbledhjes së Bordit Mbikëqyrës të AKKVP-së për miratimin e Planit vjetor të Performancës për vitin 2025
- Fillimi i fushatës informuese mbi mundësinë e parashtrimit të kërkesave për njohje ligjore të drejtave joformale pronësore, në kuadër të mandatit për informalitetin.

10. SHTOJCAT


SHTOJCA A – STRUKTURA ORGANIZATIVE E AKKVP-së



Shënim: Agjencia gjate vitit 2024 ka vazhduar të operojë me strukturën e njëjtë organizative edhe pas miratimit të Rregullores për Organizim të Brendshëm të AKKVP-së, nga Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë dhe nga organet kompetente sipas ligjit në fuqi.

* Zyrat jashtë Kosovës dhe Ekipi për Incidente pas Zbatimit nuk janë funksionale.

SHTOJCA B – STRUKTURA E RE ORGANIZATIVE E AKKVP-së E MIRATUAR NË VITIN 2024



Shënim: Agjencia gjatë vitit 2024 ka miratuar strukturën e re organizative, por për shkak të procesit të sistematizimit të vendeve të punës ka filluar të zbatohet në vitin 2025.

SHTOJCA C – BUXHETI I AKKVP-së PËR VITIN 2024

<u>Nga Buxheti i Kosovës për vitin 2024</u>	Shpenzimet vjetore	Të ndara	Nevojat shtesë
Gjithsejtë:	2,702,180	2,613,968	88,211
Paga dhe Mëditje	1,490,247	1,490,247	0
Mallra dhe Shërbime	883,410	795,199	88,211
Shërbimet Komunale	48,523	48,523	0
Investimet Kapitale	280,000	280,000	0

SHTOJCA D – BUXHETI I RISHIKUAR I AKKVP-së PËR VITIN 2024

<u>AKKVP - Buxheti i Kosovës për 2024</u>	Buxheti sipas Ligjit të Buxhetit	Buxheti i rishikuar	Të alokuara	Të paalokuara
	a	b	c	e=c-b
Gjithsejtë:	2,613,968	2,369,946	2,369,946	-
Paga dhe Mëditje	1,490,247	1,246,224	1,246,224	-
Mallra dhe Shërbime	883,410	795,199	795,199	-
Shërbimet Komunale	48,523	48,523	48,523	-
Investimet Kapitale	280,000	280,000	280,000	-

SHTOJCA E – PASQYRAT E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË AKKVP-së PËR VITIN 2024

Kodi Ekonomik	BRK	A Buxheti	B Të alokuara	C Shpenzimet	D = B – C Të papaguara	C/B Të shpenzuara %
	Gjithsejtë	2,369,946	2,369,946	2,245,975	123,971	94%
11100	Paga dhe mëditje	1,246,224	1,246,224	1,246,224	0	100%
13000	Mallra dhe shërbime	795,199	795,199	746,667	48,531	94%
13200	Shërbimet komunale	48,523	48,523	38,313	10,209	79%
30000	Shpenzimet kapitale	280,000	280,000	214,770	65,230	77%